



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.16 Date 15.09. 2010

Per:

Ndryshim Leje Shfrytezimi(Pezullim)Nr.12 date 29.01.2009 per subjektin “ Feralb shpk “.

Ne mbeshtetje te nenit 8 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore” dhe te vendimit nr. 3 date 09.01.2003 te Keshillit Kombetar te Ujit “Mbi procedurat e dhenies dhe te rinovimit te lejeve per shfrytezimin e zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjeve”, Vendimit te KKKU-se nr.01 date 21.06.2006”Per reduktimin e shfrytezimit te inerteve”, nr.01 date 13.01.2010 “Per ndalimin e dhenies se Lejeve perkohesisht per shfrytezim inertesh”, AUB Mat ka ushtruar kontrole te vazhdueshme ndaj subjekteve te lejuara per shfrytezim te inerteve. Gjithashtu me propozimin e AUB Mat, KBU Mat ka marre vendime te ndermjetme per te paralajmeruar keto subjekte per te respektuar kushtet e lejes. M.M.P.A.Ujrave ka konstatuar keto shkelje edhe nga kontrollat qe ky dikaster ka ushtruar ne lumenjte Mat dhe Fan, duke terhequr vemendjen disa here zyrtarisht per respektimin e kushteve te lejes nga subjektet e licensuara per te cilat eshte informuar edhe KBU Mat. *Subjekti “Feralb shpk “ me vendndodhje ne Pllane nuk ka sistem reperizimi te karrieres, nuk shfrytezon ne feta sipas profileve duke filluar nga aksi i lumit sipas studimit mbi te cilin eshte dhene Leja e Shfrytezimit. Nuk ka reabilituar karrieren dhe zonen ne afersi te karrieres. Nuk ka paraqit tek AUB-ja projektin e shfrytezimit dhe reabilitimit vjetor. Eshte debitor per 80250 lek. Keto shkelje bien ndesh me pikat 1,2,4,7 te lejes se shfrytezimit dhe ky subjekt eshte ne kushtet e heqjes se lejes se shfrytezimit. Gjithashtu bie ne kundërshtim me detyrat qe parashtron Plani Menaxhimit Basenit Mat per ruajtjen e biodiversitetit te lumit Mat. Eshte ne kushtet e heqjes se Lejes. Per sa me siper Keshilli Basenit Mat,*

V e n d o s i:

1. Ndryshimin e Lejes Shfrytezimit (pezullimin) per subjektin “Feralb shpk “,
2. Ngarkohet AUB Mat per zbatimin e ketij vendimi. Te bashkpunoje me INUK, ARM dhe Grupin Task-Force per ndalimin e shfrytezimit te inerteve ne zonen e ndaluar.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT
Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI

